

## Informacione lidhur me ofertat e shkollës ditore Langenthal

### Oferta

Për të gjithë fëmijët e kopshtit dhe të shkollës ofrohet kujdestari familjare plotësuese si përpara ashtu edhe pas kohës së detyrueshme të shkollës. Frekuentimi i shkollës ditore është fakultativ. Fëmijët do të caktohen në qendrat Ringstrasse (Ringstrasse 24), Hard (Bäreggstrasse 16) dhe Zwinglihaus (Bäreggstrasse 11). Të paktën gjysma e kujdestarisë përbëhet nga stafi pedagogjik profesional (neni 4 TSV).

Në ofertë bëjnë pjesë ngrënia e përbashkët e drekës dhe e pasdites. Fëmijët do të kenë përkujdesje për detyrat e shtëpisë dhe do të ndihmohen në atë, që këto t'i bëjnë vetë në mënyrë të pavarur. Këtu nuk bëhet fjalë për mësim ndihmës.

Organizimi i kohës së lirë, loja e lirë dhe mbledhja e përvojës në aktivitetet e drejtuara bëjnë pjesë në rrjedhën e ditës.

Informacionet dhe formularët për regjistrim gjenden nën:

[www.volksschule-langenthal.ch/de/angebote/tagesschule](http://www.volksschule-langenthal.ch/de/angebote/tagesschule)

### Regjistrimi

Regjistrimi bëhet me shkrim dhe është i detyrueshëm për gjithë vitin shkollor.

Oraret e aktiviteteve në veçanti gjenden në formularin e regjistrimit. Stafi i kujdestarisë në të treja qendrat mund të ndihmojë në mbushjen e formularëve dhe qëndron në dispozicion në rast pyetjesh.

**Fëmijët duhet të bëjnë regjistrim të RI për çdo vit.**

### Ndryshimi modular / njoftimi për prishje

Ndryshimet modulare janë të mundura me ndryshim të planit mësimor. Për ndryshimet dhe përshtatjet e mëvonshme të modeleve të shkollës ditore përmes prindërve, të cilat këto nuk ndodhin për shkak të ndryshimit të planit mësimor, do të caktohet një tarifë për përpunim në masën prej 100 frankash zvicerane.

Në raste të justifikuar bëhet i mundur njoftimi për prishje/prishje të pjesshme në fund të simestrit me lejën e drejtorisë së departamentit për arsim, për fëmijët dhe rininë. Njoftimi për prishje pason me shkrim përmes prindërve duke respektuar afatin e njoftimit për prishje prej dy muajsh (30 nëntor 2016). Përrjashtim: Në rast transferimi afati i lajmërimit për prishjen është dy muaj për në fund të muajit.

### Transporti / Shoqërimi

Sipas mundësisë fëmijët frekuentojnë atë qendër, e cila ndodhet më afër kopshtit apo shkollës. Në rast se për shkak të mungesës së vendeve kjo nuk do të jetë e mundur, atëherë fëmijët do të shoqërohen gjatë rrugës së ardhjes dhe kthimit.

Shoqërimet do të organizohen më këmbë (për rrugë të shkurtra) për fëmijët deri në, edhe të klasës së 2-të, me transport autobusi (për rrugë të largëta) për fëmijët deri në, edhe të klasës së 3-të. Shpenzimet për shoqërimin dhe transportin merren përsipër nga qyteti Langenthal.

### Orari i hapjes / Pasdita e dyerve të hapura

Shkolla ditore është e hapur gjatë kohës së shkollës nga e hëna deri të premte, përveç ditëve të festave.

Në qershor janë të ftuar të gjithë prindërit, fëmijët dhe stafi mësimor në pasditen e dyerëve të hapura në të gjitha qendrat.

### Tarifat / Përrjashtimi për mospagesën e tarifave

Tarifat llogariten në bazë të regjistrimit dhe caktohen në bazë të të ardhurave dhe pasurive të prindërve. Parimisht mungesat e fëmijëve nuk çojnë në ulje të tarifave, përkundrazi për kompensim të mungesave në shkollë nuk llogaritet java e fundit e shkollës përpara pushimeve verore. Në llogari do të vihet i gjithë programi, edhe në rast se fëmijët do të kthehen më herët në shtëpi.

Një vlerësim i kostos mund të bëhet edhe në faqen e internetit të drejtorisë për edukim të Kantonit të Bern-ës nën linkun [www.erp.be.ch/tagesschulen/tarifrechner](http://www.erp.be.ch/tagesschulen/tarifrechner) ose në bazë të listës së mëposhtme të tarifave.

Çmimi i drekës është global 9.00 franka zvicerane. Këtu shtohen edhe shpenzimet për kujdestari. Nuk do të llogaritet dreka, për të cilën bëhet çlajmërimi një ditë më parë, apo përpara orës 8.30.

**Llogaritë e papaguara do të merren në rrugën e rregullt ligjore. Në rast se nuk do të paguhet tarifat për drekën dhe kujdestarinë, atëherë drejtoria e shkollës ditore rezervon të drejtën të refuzojë për vitin e ardhshëm pranimin e fëmijës/fëmijëve në shkollën ditore.**

**Luteni që për tarifat t'i referoheni fletës informative në gjermanisht.**